

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKTA E APELIT E KOSOVËS- Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët, Mejreme Memaj kryetare e kolegjit, Have Haliti dhe Driton Muharremi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit O.Z. nga komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me par.4 të KPRK-së, sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit O.Z. av. K.B., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë . PKR.nr.562/16 të dt. 21.11.2016, në seancën e kolegjit, me datë 21.03.2017 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin ankesës së mbrojtësit të akuzuarit O.Z., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.562/16 i dt. 21.11.2016, vetëm përkitazi me vendimit mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin O.Z., për veprën penale me të cilën është shpallur fajtor Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 në lidhur me par. 4 të KPRK-së, për pjesën e mbetur të dënimin të shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, ku i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 29.07.16 deri me datën 21.11.2016, i zëvendësohet konform nenit 47 të KPRK, me dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, kurse dënimin me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, e merr si të vërtetuar, ashtu që konform nenit 80 të KPRK i shqiptohet dënimin unik me gjobë në shumë prej 1500 euro, të cilin dënim do të paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse dënimin me gjobë i akuzuari nuk e paguan në afatin e caktuar, dënimin me gjobë ka me u ekzekutuar me detyrim, ashtu që për çdo 20 euro, do të zëvendësohet me një ditë burgim.

II. Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i paprekur.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore-Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.562/16 të dt.21.11.2016, e ka shpallur fajtor të akuzuarin O.Z. për shkak të veprës penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me par. 4 të KPRK-ës, dhe e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej datës 29.07.16 deri me datën 21.11.2016, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj pas plotfuqishmërisë së

aktgjykimit , po qe se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, atëherë dënimi me gjobë do të i shëndrrohet në dënim burgu, ku një ditë burgim do ti llogaritet në shumë prej 20 euro. Të akuzuarit i është shqiptuar dënimi plotësues, konfiskimi i narkotikëve Methylenedioxymethamphetamin me peshë prej 34.25gr. ndërsa vetura e tipit "Audio A6" me targa të regjistrimit ... i është liruar. Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve dhe të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 100 euro, kurse shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë se gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka parashtruar ;

Mbrojtësi i të akuzuarit O.Z., av. K.B., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që dënimi i shqiptuar me burgim prej 6 muajsh, të i zëvendësohet me dënim me gjobë.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/I.nr. 65/16 të datës 2.02.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit konform nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK-së, në të cilën prezantoi i akuzuari O.Z. av. K.B., ndërsa në seancë nuk prezantoi Prokurori i Apelit, edhe pse ishte njoftuar me rregull për seancën e kolegjit.

Gjykata shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit dhe gjeti se :

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit është e bazuar.

Gjykata e Apelit duke pasur parasysh se aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, të njëjtin e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Por ashtu, as gjendja fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi nga kjo gjykatë, me ankesë nuk mund të kontestohet aktgjykimi konform nenit 383 par. 2 të KPPK-së, sepse i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën e cila i vihet në barrë, pas konsultimit me mbrojtësin e tij, kryetari i trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj aktgjykimin e ankimuar kjo gjykatë e vlerësoj vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore, përkitazi me vendimin mbi dënimin.

Mbrojtësi i të akuzuarit, në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së dënimit i ka zbatuar drejtë dispozitat për zbutjen e dënimit, sepse kanë ekzistuar rrethana posaçërisht lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, bazuar në të gjitha këto rrethana ka propozuar që dënimi i mbetur me burgim, të i zëvendësohet me dënim me gjobë, konform nenit 47 të KPRK-së, duke pasur parasysh se i akuzuari është student, ka një biznes të vetin dhe shkuarja e tij në mbajtjen e dënimit me burgim, do të ndikonte negativisht në risocializimin e tij të dispozitivit të aktgjykimit, ti shqiptoj dënim më të butë, më të cilin mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese, kështu që të akuzuarit, si rrethana lehtësuese, ka marrë parasysh moshën e re, është penduar për veprën e kryer penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale, kurse si rrethana posaqërisht lehtësuese ka marrë për bazë pranimin e fajësisë për veprën e kryer penale, ashtu që konform nenit 75 dhe 76 të KPRK-së, ka bërë zbutjen e dënimit, kurse rrethana rëndues nuk ka gjetur.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, gjykata e shkallës së parë me rastin e përcaktimit të dënimit ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, si pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin e shprehur, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale, moshën e re, duke i pasur parasysh të gjitha këto rrethana lehtësuese i ka aplikuar dispozitat e zbutjes se dënimit dhe i ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë me ligj, ashtu që në praninë e rrethanave lehtësuese dhe në mungesë të rrethanave rënduese, kjo gjykatë merr parasysh edhe faktin, se të akuzuarit nga dënimi i shqiptuar i kanë mbetur për ti mbajtur edhe 2 muaj e 8 ditë, është student, se me vetë pranimin e fajësisë është penduar dhe vetëdijësuar se substanca narkotike është e rrezikshme për shëndetin e tij dhe të tjerëve, andaj konform dispozitave të nenit 47 të KPRK-së , dënimi i mbetur, i është zëvendësuar me dënim me gjobë, si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sipas kësaj Gjykate, dënimi i ndryshuar nga kjo gjykatë është në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës se mbrojtur, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tij dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënimin ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Nga çka u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 403 të KPPK- së.

## GJYKATA E APLEIT E KOSOVËS

PAKR.nr. 53/17 i datës 21.03.2017

Procesmbajtësi  
Eroll Gashi

Antarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit  
1.Mejreme Memaj

1. Have Haliti \_\_\_\_\_

2. Driton Muharremi \_\_\_\_\_